

**Titulli, rezymeja, fjalët çelës shqip**  
**“Proza e Fatos Kongolit”**

**REZYME**

Gjatë studimeve themelore (bachelor) dhe në ato pasuniversitare (master) romani bashkëkohor shqiptar, gjithnjë na ka tërhequr dhe interesimi ynë për të shkruar rreth tij ka qenë i vazhdueshëm. Dy fazat e mëparshme të studimeve tona universitare në Degën e Letërsisë në Fakultetin e Filologjisë- Universiteti i Prishtinës, na kanë njohur më shumë vepra e autorë tanë bashkëkohor, gjë që ka nxitur kureshtjen tonë për studime të mëtejshme.

Pra, kemi bërë lexime të një sërë autorëve dhe veprave, ku kemi parë veçori e karakteristika të ndryshme formale e ideore. Në këtë orvatje tonë kërkimore, jemi takuar edhe me romanet e Fatos Kongolit, që është njëri nga autorët më produktivë dhe më domethënës të bashkëkohësisë letrare shqiptare. Ai i dha dhe është duke i dhënë letrave shqipe mjaftueshëm, duke qenë njëri nga zërat më të veçanta të prozës sonë. Te ky autor kemi parë një simbiozë të mendimit dhe formës, idesë dhe stilit, dhe trajtimit të veçantë të ngjarjeve dhe personazheve që ai i ka krijuar. Kjo e bën Kongolin që të vlerësohet si një nga shkrimtarët më reprezentativë të tranzicionit në Shqipëri.

I lindur në Elbasan në vitin 1944 dhe i shkolluar për studime të larta në fushën e matematikës në Universitetin e Tiranës dhe Pekinit, ai me precizitet të lakmueshëm i ndërton situatat narrative dhe i ndërlidh veprimet e protagonistëve të tij me temat dhe idetë që dalin prej teksteve të tij narrative. Ka një ftohtësi në përshkrimin e situatave dhe veprimeve të romaneve të Kongolit dhe një motivim të pashoq të karaktereve, gjë që është një cilësim që do ta lakmonin shumë krijues të artit letrar narrativ.

E veçanta e këtij autori është se nuk i përmbahet vetëm një modeli të shkrimit të letërsisë apo një formacioni letrar, por i kombinon ato për nevojat e tekstit të tij narrativ dhe mesazheve e temave që i trajton. Kjo gjë e bën sa domethënës, po aq edhe intrigues.

Fatos Kongoli është një nga autorët më produktivë të njëzetë viteve të fundit në letërsinë shqipe. Ai është autor i katërbëdhjetë romaneve, të cilat kanë zënë vend në diskutimet tona letrare. Që nga botimi i romanit të tij të parë (“Ne të tre”) dhe deri te botimi i romanit të tij të fundit (“Njeriu me fat”), gjithnjë ka pasur një interesim të vazhdueshëm dhe një pëlqim të mirë, si nga lexuesi në përgjithësi, por edhe nga kritika e specializuar letrare, ku hasim një mori shkrimesh e vlerësimesh për veprën e këtij autori. Pra, përpos që është produktiv, Kongoli është edhe njëri nga autorët më të vlerësuar nga kritika letrare shqiptare, si dhe ndër shkrimtarët më të lexuar nga lexuesi shqiptar. Edhe pse në fillimet e tij ai u mor me tregime, njohja e tij nga lexuesi dhe kritika shqiptare u bë përmes romanit. Edhe sot e kësaj dite, romanet e tij vazhdojnë të jenë më të kërkuarat nga artdashësit shqiptarë. Veçanërisht romani i tij “I humburi” u shndërrua në një roman-kult për periudhën e tranzicionit shqiptar, për periudhën kalimtare në mes të komunizmit dhe demokracisë në Shqipëri.

“I humburi” është njëlloj pasaporte e letërsisë narrative të Fatos Kongolit. Përmes tij ai u bë i njohur e i dashuri, si për lexuesin tonë, po ashtu edhe për atë të huaj. Ky është romani që ia hapi dyert vendore e ndërkombëtare, duke i përkthyer në shumë gjuhë të njohura të botës. Për këtë roman kanë folur e kanë shkruar shkrimtarë e kritikë evropianë, veçmas ata francezë, duke e vlerësuar lart këtë roman të autorit shqiptar. Përveç këtij romani, neve na kanë lënë përshtypje dhe na kanë sfiduar me elementet e tyre tematike e ideore edhe romanet “Te porta e Shën Pjetrit” dhe “Lëkura e qenit”, që për mendimin tonë, përbëjnë atë treshen kryesore të veprave narrative të Fatos Kongolit. Ky është vetëm një mendim i jonë dhe secili lexues e studiues mund ta ketë përzgjedhjen e tij në mesin e opusit të madh romanësor të këtij autori. Pra, është vetëm një përzgjedhje e jona subjektive, e bazuar në leximin tonë, shijet tona estetike dhe formimin tonë letrar e kulturor. Por, përveç romaneve që i përmendëm deri më tash, ne nuk mund t’i lëmë anash pa i përmendur edhe romanet e tjera të këtij autori, sikurse që janë: “Kufoma”, “Bolero në vilen e pleqve”, “Ëndrra e Damokleut”, “Dragoi i fildishtë”, “Gjemia e mbytur”, “Jeta në një kuti shkrepsësh”, “Karuseli”, “Ne të tre”, “Njeriu me fat”, “Si-do-re-la”, duke mos e lënë anash as romanin autobiografik “Iluzione në sirtar”, që në kohën e botimit të tij është vlerësuar si një nga rrëfimet më të sinqerta për vetveten në letërsinë shqipe. Edhe pse krijimtarinë e tij narrative, Fatos Kongoli e nisi me tregime, nuk është se pati ndonjë sukses në këtë zhanër të prozës artistike, andaj ai pa dyshim se mund të cilësohet si një nga mjeshtërit e romanit bashkëkohor shqiptar. Për secilin prej romaneve të lartcekura mund të bëhet një punim i gjatë, së paku

disertacion masteri, meqë ka elemente të ndryshme e të larmishme, që na jep mundësi dhe kanë potencial të mjaftueshëm për t'i analizuar dhe interpretuar. Romanet e tij mund të lexohet si për nga aspekti i tyre narrativ, pikëshikimet dhe pozicionet e narratorëve, po ashtu edhe për nga aspekti i ideve dhe mesazheve që mund të prodhojë bota narrative e krijuar nga Fatos Kongoli.

Sa i përket metodologjisë së punës, mund të themi se jemi përpjekur ta përdorim një lloj mënyre të vrojtimit që mund të cilësohet si integrale, duke qenë se kemi folur njëkohësisht edhe për anën formale edhe për atë ideore të tekstit. I kemi parë dy aspektet e sipërshënuara në funksion të vlerës së veprës letrare të Fatos Kongolit, kështu që nuk kemi mundur që t'i shohim ndarazi. Mund të themi se dominon analiza tematike dhe analiza e personazhit, meqë te tipizimi i këtij të fundit qëndron njëra nga esencat e letërsisë së Kongolit.

Kongoli si prozator është specifik në mënyrën e modelimit të narracionit, me një lëvizje të kohëve dhe perspektivave të rrëfimit. Një lëvizje e tillë, sa në të tashmen e sa në të kaluarën është shënjuese e mënyrës së rrëfimit të këtij autori. Përpos lëvizshmërisë së kohëve, kemi edhe lëvizje të hapësirave të rrëfimit, ambienteve në të cilat e për të cilat zhvillohet rrëfimi. Një lëvizje e tillë i jep ngjyrë romaneve të tij dhe i bën më të këndshëm për lexim dhe më të kapshëm për interpretim dhe analizë të tyre. Në romanet e tij kemi edhe ndryshime të vetave të rrëfimit, ku herë kemi narratorin e brendshëm (homodiegetik) e herë narratorin e jashtëm (heterodiegetik). Veta e tretë na jep zakonisht narratorin heterodiegetik, ndërsa e para homodiegetikun. Një ndryshim i tillë vetash shihet edhe brenda një kapitulli, në shumë prej romaneve të Fatos Kongolit. Një gjë e tillë e formëson një lloj loje narrative, ku vetat lëvizin në mënyrën paralele me ndryshimet tematike dhe me ndryshimin e perspektivave dhe qasjes së personazheve ndaj të tjerëve që janë akterë në rrëfimin e secilit roman. Pra, një veçori që nuk haset shpesh në romanin bashkëkohor shqiptar. Ajo që ia vlen të themi paraprakisht është se romanet e Kongolit nuk janë linear. Nuk kemi një zhvillim të drejtpërdrejtë e të njëtrajtshëm të një ngjarje nga fillimi e deri në fund. Këtë e themi sepse kemi një ndërfaqje të kohëve dhe situatave të ndryshme narrative, që nuk mund ta japin atë që mund të cilësohet si linearitet narrativ. Shpeshherë në romane të tillë kemi narracion paralel, ku dy osë më shumë situata mund të zhvillohet njëkohësisht e paralelisht. Kemi konstatuar se ndërtimi i personazhit është një nga pikat më të forta të letërsisë së Kongolit. Te proza e tij kemi personazhin veprues dhe atë vëzhgues, personazhin kujtimtar dhe

personazhin e dëshpëruar, që profilizohen në bazë të veprimeve dhe motiveve tematike të romaneve në të cilat ata janë të pranishëm. Fatos Kongoli pikën qendrore në çështjen e personazheve e vë mbi kryeprotagonistin, rreth të cilit sillet i gjithë rrëfimi, dhe shumica e situatava, motivet dhe personazhet episodike janë mjete ndihmëse për realizimin dhe portretizimin e tij. Megjithatë, kemi edhe personazhe dytësore që janë mjaft domethënëse në rrëfimin e romaneve të caktuara të këtij autori, sikurse ta zëmë Sonja, Vilma te romani “I humburi”, Sabit Kurti te romanet “Te porta e Shën Pjetri” dhe “Njeriu me fat”, Valmir D., te romani “Kufoma” etj. Duhet ta cekim se të gjithë kryeprotagonistët në romanet e Kongolit janë të gjinisë mashkullore, përveç Parashqevisë, që është kryeprotagoniste në romanin “Bolero në vilen e pleqve”. Pra, e kemi vetëm një kryeprotagoniste grua.

Mund të konstatojmë se personazhi identifikues i letërsisë dhe prozës së Fatos Kongolit është Thesar Lumi, kryeprotagonisi i romanit “I humburi”. Me këtë roman dhe me këtë personazh ai është bërë i njohur si për lexuesin vendor, po ashtu edhe atë ndërkombëtar. Po ashtu mund ta ngrisim tezën se në romanet e Fatos Kongolit e shohim personazhin vëzhgues, i cili më shumë i vrojton të tjerët se sa që vepron vetë. Pra, një personazh survejues. Ky është tip që na shfaqet më së shpeshti në mesin e protagonistëve të romaneve të Fatos Kongolit.

Gjatë një analize tematike mbi romanet e Fatos Kongolit kemi ardhur në përfundim se shikuar në këtë aspekt tematik, letërsia e këtij autori i prek dy tema a dy rrëfime të mëdha, atë për diktaturën komuniste dhe atë për tranzicionin politik e shoqëror, që ngjau në Shqipëri pas rënies së sistemit totalitar. Në shumë romane këto dy aspekte tematike i shohim bashkë, në të të njëjtim rrëfim e tekst letrar, por kemi edhe një sërë tekstesh, që marrë proporcionalisht rrëfejnë më shumë për tranzicionin, gjithnjë duke i pasur parasysh pasojat e diktaturës te shoqëria në përgjithësi dhe të individit në veçanti, i cili përfaqësohet këtu përmes personazhit të Kongolit.

Romanet e Fatos Kongolit, duke filluar nga “Ne të tre” e deri te ai i botuar së fundmi “Njeriu me fat” kanë tema dhe motive tematike që herë pas here barten te njeri-tjetri. Pra, temat pak a shumë të njëjta shihen të trajtuara në disa romane. Edhe pse kemi një sërë motivesh të larmishme tematike, në romanet e Fatos Kongolit i hasim dy tema kryesore apo dy kode tematike, me të cilët identifikohet shkrimtaria e tij. Duke qenë se protagonistët kryesorë të romaneve të këtij autori janë të dyzuar në mes të së kaluarës dhe të së tashmes, atëherë

natyrshëm se prodhohen dy kohë të rrëfimit në romanet e Kongolit, dhe dy kohët e tilla janë periudha e diktaturës komuniste dhe ajo e tranzicionit demokratik.

Pra, mbesim me shpresë se kemi arritur ta realizojmë një punim korrekt për një autor të rëndësishëm të letërsisë shqipe.

**Fjalët çelës:** Fatos Kongoli, letërsia shqipe, proza, rrëfimi, tema, motivi, personazhi, diktatura komuniste, tranzicioni politik, etj.

**Titulli, rezymeja, fjalët çelës anglisht**

## **"Prose of Fatos Kongoli"**

### **RÉSUMÉ**

During the basic (bachelor) and postgraduate (master) studies, the contemporary Albanian novel has always, attracted us and our interest in writing about it has been continuous. The two previous phases of our undergraduate studies at the Department of Literature at the Faculty of Philology - University of Prishtina, have informed us more of our contemporary works and authors, which has stimulated our curiosity for further studies.

So we have made readings of a number of authors and works, where we have seen different features and different formal and conceptual features. In this research endeavor, we have also met with the novels of Fatos Kongoli, one of the most productive and significant authors of Albanian literary contemporaneity. He gave and is giving the Albanian letters enough, being one of the most special voices of our prose. In this author we have seen a symbiosis of thought and form, idea and style, and the special handling of events and characters that he has created. This makes Kongoli to be considered as one of the most representative transition writers in Albania.

Born in Elbasan in 1944 and educated for higher studies in mathematics in Tirana and Beijing University, he accurately and enviable constructs the narrative situations and relate the actions of his protagonists with themes and ideas that arise from his narrative texts. There is a coldness in describing the situations and actions of Kongoli's novels and an unmatched motivation of the characters, which is a qualification that would covet many creators of narrative literary art.

The author's special feature is that he does not only stick to a literary writing model or a literary formation, but combines them for the needs of his narrative text and the messages and topics he deals with. This makes it as meaningful, as intriguing.

Fatos Kongoli is one of the most productive writers of the last twenty years in Albanian literature. He is the author of fourteen novels, which have taken place in our literary discussions. Since the publication of his first novel ("Ne të tre") and the publication of his latest novel ("Njeriu me fat"), there has always been a constant interest and a good liking, as by the reader in general, but also by specialized literary criticism, where we encounter a host of writings and assessments for the work of this author. So, besides being productive, Kongoli is also one of the most esteemed authors of Albanian literary criticism, as well as among the most read writers of the Albanian reader. Although in his beginnings he was taken with stories, his recognition by Albanian reader and criticism was made through the novel. To this day, his novels continue to be the most sought after by Albanian artisans. Especially his novel "I humburi" turned into a cult-novel for the Albanian transition period, for the transitional period between communism and democracy in Albania.

"I humburi" is a kind of passport for Fatos Kongoli's narrative literature. Through it he became known and loved, both for our reader as well as for a foreign ones. This is the novel that opened him local and international doors, translating it into many of the world's well-known languages. For this novel, European writers and critics have spoken and written, especially the French ones, highly appreciating this novel by the Albanian author. Apart from this novel, we have impressed and challenged with their thematic and conceptual elements by the novels "Te porta e Shën Pjetrit" and "Lëkura e qenit", which in our opinion constitute the main triad of the narrative works of Fatos Kongoli. This is just one of our thoughts and each reader and scholar may have his selection among the great novel opus of this author. So it is just a subjective choice

based on our reading, our aesthetic tastes and our literary and cultural formation. But apart from the novels we have mentioned so far, we cannot leave it without mentioning the other novels of this author, such as: “Kufoma”, “Bolero në vilen e pleqve”, “Ëndrra e Damokleut”, “Dragoi i fildishtë”, “Gjemia e mbytur”, “Jeta në një kuti shkrepsësh”, “Karuseli”, “Ne të tre”, “Njeriu me fat”, “Si-do-re-la” without leaving aside the autobiographical novel "Illusion in the Drawer", which at the time of its publication was considered one of the most sincere stories about oneself in Albanian literature. Although his narrative creativity, Fatos Kongoli started with stories, he did not have any success in this genre of artistic prose, so he can no doubt qualify himself as one of the masters of the contemporary Albanian novel. For each of the abovementioned novels, a long work, at least master dissertation, can be done, as there are diverse and varied elements that give us opportunities and have enough potential to analyze and interpret. His novels can be read as from their narrative aspect, viewpoint and the position of narrators, as well as from the aspect of the ideas and messages that the narrative world created by Fatos Congoli can produce.

Regarding the work methodology, we can say that we have tried to use a kind of observation that can be considered as integral, since we have talked simultaneously both for the formal side and for that conceptual text. We have seen the two above-mentioned aspects in function of the value of the literary work of Fatos Kongoli, so we could not see them separately. We can say that the thematic analysis and character analysis dominates, since the characterization of the latter is one of the essences of Kongoli’s literature.

Kongoli as a prose writer is specific in the way of narrative modeling, with a movement of times and perspectives of storytelling. Such a movement, as in the present than in the past, is a mark of the narrative way of this author. Apart from the mobility of times, we also have movement of story spaces, environments in which the story unfolds. Such a movement gives color to his novels and makes them more enjoyable for reading and more accessible for their interpretation and analysis. In his novels we also have changes of narration persons, where sometimes we have the internal narrator (homodiegetic) and sometime the external narrator (heterodiegetic). The third person usually gives us the heterodiegetic narrator, while the first one is homodiegetic. Such a change is seen even within a chapter, in many of Fatos Kongoli's novels. Such a thing forms a kind of narrative game where people move in parallel with thematic changes and changing the perspectives and approaches of characters to others who are actors in

the story of each novel. Pra, një veçori që nuk haset shpesh në romanin bashkëkohor shqiptar. What is worth saying is that Kongoli's novels are not linear. We do not have a straightforward and consistent development of an event from the beginning to the end. This is because we have a fusion of different narrative times and situations that can not give what can be termed narrative linearity. Often in such novels there is a parallel narrative, where two or more situations can develop simultaneously and in parallel.

We have found that character building is one of the strongest points in the literature of Kongoli. In his prose have the acting character and the observer, the meditative character and the desperate character, profiled based on thematic actions and motives of the novels in which they are present. Fatos Kongoli the central point in the characters' case puts on major protagonist around whom the whole story, most of the situations and motifs are about, while episodic characters are auxiliary tools for his realization and portrayal. However, we also have secondary characters that are quite significant in the narrative of certain novels of this author, like for instance Sonja, Vilma in the novel "I humburi", Sabit Kurti in the novels "Te porta e Shën Pjetri" dhe "Njeriu me fat", Valmir D., in the novel "Kufoma" etc. It should be noted that all the major protagonists in the novels of the Kongoli are male, except for Parashqevia, which is the major protagonist in the novel "Bolero në vilen e pleqve". So, we have only one woman major protagonists.

We can conclude that the identity character of Fatos Kongoli's literature and prose is Thesar Lumi, the leading protagonist of the novel "I humburi". With this novel and with this character he has become known both for the local reader as well as the international reader. We can also raise the thesis that in the novels of Fatos Kongoli we see the observer character, who more observes others than acting himself. So, a surveillance character. Ky është tip që na shfaqet më së shpeshti në mesin e protagonistëve të romaneve të Fatos Kongolit.

During a thematic analysis on the novels of Fatos Kongoli we have come to the conclusion that looking at this thematic aspect, the literature of this author touches two topics or two great stories, that of communist dictatorship and that of the political and social transition that resembled Albania after the collapse of the totalitarian system. In many novels we see these two thematic aspects together in the same story and literary text, but we also have a number of texts that proportionately tell the story more about the transition, always taking into account the



consequences of dictatorship to the society in general and the individual in particular, represented here through the Kongoli's protagonist.

The Fatos Congolese novels, starting with "Ne të tre", up to the recently published "Njeriu me fat" have themes and thematic motifs that are occasionally transferred to each other. So, more or less the same topics are viewed in some novels. Although we have a variety of thematic motifs, in Fatos Kongoli's novels, we find two main themes or two thematic codes, identifying his writings. Since the main protagonists of this novel's novels are doubled between the past and the present, then naturally two story times are produced in the Kongoli's novels, and two such times are the period of communist dictatorship and that of a democratic transition.

So, hopefully we have managed to accomplish a correct work for an important author of Albanian literature.

Key words: Fatos Kongoli, Albanian literature, prose, narrative, theme, motive, character, communist dictatorship, political transition, etc.